

**MUHARREM DEZHGIU**

**GJERMANËT NË SHQIPËRI  
(verë - vjeshtë 1943)**

Raportet e shqiptarëve me gjermanët, gjatë shekullit të kaluar, patën një kulm të veçantë gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Në periudhën e paraluftës, marrëdhëniet ndërshtetërore gjermano-shqiptare ishin të kufizuara. Kjo shkallë e ulët e marrëdhënieve midis dy vendeve ishte refleksi i pozitës sunduese të ndikimit italian në Shqipëri. Politika gjermane ishte e painteresuar ndaj Shqipërisë, duke marrë në konsideratë xhelozinë italiane ndaj çdo shteti që shfaqte interesa për marrëdhënie preferenciale ndaj Shqipërisë, të cilën, Italia, e konsideronte si “domenin” e saj.

Këtë situatë të marrëdhënieve të Shqipërisë së paraluftës me Italinë dhe Gjermaninë e kanë vënë në dukje dhe studiues të ndryshëm. Kështu, duke iu referuar kësaj situatë të marrëdhënieve të Shqipërisë me pushtuesit e ardhshëm, studiuesit kanë pohuar: “Ministria e Jashtme Gjermane ishte e lëkundur, veçanërisht pasi italianët u bënë thujtë historikë, kur morën vesh përçapjet e Frashërit (Mehdi Frashëri – M.D.) për bisedime me gjermanët”.<sup>1</sup>

Ndoshta, ishte edhe kjo një ndër arsytet që i kushtoi Mehdi Frashërit largimin nga posti i kryeministrit, duke qenë i njohur si simpatizant i gjermanëve. Edhe përfaqësuesi gjerman në Shqipëri, Eberhard von Pannwitz, në raportet e tij, shprehte zhgënjimin për shkallën e ulët të ndikimit gjerman në Shqipëri. Përpyqjet e tij për një marrëveshje të re tregtare me Shqipërinë, në vitin 1938, nuk patën rezultat për shkak të kontrollit ekonomik italian mbi Shqipërinë.<sup>2</sup>

Shkalla e ulët e raporteve shqiptaro-gjermane, para Luftës së Dytë Botërore, do të shprehej edhe në përgjigjen negative të Hitlerit ndaj kërkesës së Mbretit shqiptar, në mars të vitit 1939, për ta mbrojtur atë nga

---

<sup>1</sup> Bernhard Kühmel, *Deutschland und Albanien 1943-1944*, Die Auswirkungen der Besetzung und die innenpolitische Entwicklung des Landes Ruhr, Universität Bochum: tezë doktorate, 1981, f. 79. (Cituar sipas Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës (1939-1945)*, Tiranë: “Çabej”, 1999, f. 213).

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 82.

Musolini.<sup>3</sup> Megjithatë, Zogu nuk shihte ndonjë optimizëm në ndihmën gjermane për mbrojtjen e tij nga italianët. Vetëm gjatë Luftës, në rrethanat e zhvillimit të ngjarjeve në Ballkan dhe në Shqipëri, interesi gjerman për Shqipërinë u shpreh me një vëmendje të veçantë.

\*

\* \*

Pushtimi i vendeve ballkanike, në vitin 1941, nga Boshti Italo-Gjerman, përcaktoi vendosjen e raporteve të caktuara të shqiptarëve ndaj këtij Boshti. Në qëndrimin e shqiptarëve ndaj pushtuesve italo-gjermanë luajti një ndikim të fuqishëm rikonfigurimi i zonave të pushtimit të këtyre fuqive. Si rezultat i drejtpërdrejtë i ndarjes së zonave të pushtimit, trevat shqiptare, shumica e tyre, u bashkuan duke u përfshirë në zonën italiane të pushtimit. Pa dyshim, pozita e shqiptarëve të Kosovës dhe të trevave të tjera, që iu bashkuan Mbretërisë Shqiptare, u përjetua si çlirim nga sundimi sllav.

Për herë të parë shqiptarët e këtyre trevave bënë pjesë në një njësi administrative të përbashkët, nën emërtimin “Mbretëria Shqiptare”, qeveriseshin nga një administratë shqiptare dhe bënë një jetë ekonomike të përbashkët. Shqiptarët mësonin në shkolla në gjuhën shqipe, me mësues shqiptarë. Me fjalë të tjera, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, që u bashkuan në Mbretërinë Shqiptare, përjetuan të gjitha ato të drejta e liri kombëtare, të cilat u ishin mohuar më parë nga sundimi jugosllav. Nisur nga këto rrethana politike, të paspushtimit të Jugosllavisë, edhe qëndresa e shqiptarëve kundër pushtuesve të Shqipërisë, nuk pati përmasa të njëjta në të gjitha trevat shqiptare. Nga sa thamë më lart, një dukuri e tillë ishte më se e kuptueshme.

Gjatë periudhës së pushtimit italian, shqiptarët e të gjitha trevave nuk arritën të përcaktonin një qëndrim unik kundër tij. Përpjekjet e forcave politike shqiptare, për të ndërtuar një strategji dhe taktikë të përbashkët organizimi e veprimi, nuk patën ndonjë rezultat. Ka shumë arsye dhe faktorë që ndikuan në këtë proces të mosbashkimit të të gjithë shqiptarëve në një front të përbashkët qëndrese kundrejt pushtuesit.

Secili nga studiuesit mund t’i rendiste këta faktorë pengues, sipas peshës e rëndësisë së tyre. Qasja ndaj problemit kombëtar, i pazgjdhur para lufte, i vuri shqiptarët në një pozitë të pabarabartë, për të vepruar në mënyrë unike, në kushtet e pushtimit të huaj.

<sup>3</sup> B.J.Fischer, *vep. e përm.*, f. 213.

Pas kapitullimit të Italisë, më 8 shtator 1943, dolën në skenë faktorë e rrethana të reja politike për të ndryshuar shumë koncepte në procesin e qëndrimit në luftë, për të gjitha palët e inkuadruara në të.

Kapitullimi i Italisë impononte për aleaten e saj, Gjermaninë, për zgjidhjen e detyrave urgjente, në situatën e krijuar. Sigurisht, të dyja palët e mëdha ndërluftuese, synonin të zinin vendin e Italisë kapitulluese në rajonet që ajo kishte pushtuar. Shqipëria ishte një rajon tepër strategjik si për forcat e Boshtit Fashist, ashtu dhe për Forcat Aleate Antifashiste.

Gjermania, si aleate e Italisë, i kushtoi vëmendje të posaçme trevave shqiptare, për t'i pushtuar dhe për t'i shfrytëzuar në funksion të strategjisë së saj të luftës. Njëherazi, gjermanët shtruan edhe çështjen e qëndrimit ndaj shqiptarëve duke pasur në konsideratë dhe ndjeshmërinë antiitaliane të lartë të tyre, që patën rolin e vet në kapitullimin e Italisë. Interesimi i veçantë i gjermanëve për Shqipërinë lidhej edhe me informacionet që bënin fjalë për një zbarkim të mundshëm të Aleatëve Antifashistë në Ballkan. Duke e vlerësuar pozitën e vështirë të Italisë pas rënies së Musolinit (korrik 1943), Gjermania mori masat për të sjellë trupa të veta në Shqipëri. Fillimisht, sjellja e këtyre forcave do të arsyetohej si një "ndihmë" ndaj aleatit të vet, në situatë të vështirë. Më vonë, Gjermania do ta shfrytëzonte situatën për të zënë pozitat strategjike në Shqipëri, duke zëvendësuar pushtuesin italian të kapitulluar.

Për të njohur situatën në Shqipëri, qysh në prill 1943, ishin dërguar në Mitrovicë, disa njësi të zbulimit gjerman, për të ushtruar ndikim tek shqiptarët e pakënaqur nga italianët.<sup>4</sup> Edhe pse qeveria e Badolios, që erdhi në Itali pas Musolinit, kishte shpallur se, luftën do ta vazhdonte si aleate e Gjermanisë, kjo e fundit e humbi besimin në vlerën e mëtejshme të aleancës me Italinë. Prandaj, në korrik dhe gusht të vitit 1943, ushtria gjermane u vendos në aeroportet dhe portet shqiptare. Sipas burimeve, në mesin e gushtit 1943 ishin vendosur në Shqipëri rreth 6.000 forca ushtarake gjermane.<sup>5</sup>

Është për t'u vënë në dukje se, lëvizja e parë politike e Ministrisë së Jashtme Gjermane në drejtim të Shqipërisë ishte emërimi i Hermann Neubacherit, si përfaqësues i posaçëm i ministrit të Jashtëm për Europën

---

<sup>4</sup> Paul Leverkühn, *German Military Intelligence*, Weidenfeld und Nicholson, London: 1954, f. 152. (Cituar sipas B.J.Fischer, *vep. e përm.*, f. 214).

<sup>5</sup> Martin Seckendorf, *Die Okkupation politik des deutschen Faschismus in Jugoslawien, Griechenland, Albanien, Italien und Ungarn, 1941-1945*, Berlin: 1992, f.77.

Juglindore. Emërimi i tij, në këtë detyrë, do të kishte rëndësi dhe peshë të veçantë edhe për çështjet shqiptare. Më parë, ai ishte marrë me çështjet ekonomike të Ballkanit, si përfaqësues i Hitlerit.<sup>6</sup> Megjithatë, para 10 shtatorit 1943, ai nuk kishte marrë ndonjë detyrë të posaçme për Shqipërinë.

Interesimi politik i Gjermanisë për Shqipërinë mori peshë më të madhe me dërgimin e majorit Franz von Scheiger në Mitrovicë. Ai ishte njohës i mirë i Shqipërisë dhe i shqiptarëve, që nga koha e Luftës I Botërore, kur ai kishte njohur personalisht njerëz të shumtë, si dhe shumë politikanë shqiptarë me influencë. Duke qenë në Mitrovicën e pushtuar nga gjermanët, me një funksion ushtarak, që nga 2 shtatori 1943, Scheiger pati mundësi të bisedonte dhe të ndikonte tek udhëheqësit vendës.<sup>7</sup> Kjo detyrë iu ngarkua Scheiger-it ta kryente në Mitrovicë, duke pasur parasysh, se ky territor ishte nën kontrollin e gjermanëve, por ishte shumë afër trevave shqiptare, që ishin nën pushtimin italian. Veçoria e aksionit të tij qëndronte në faktin se, ai nuk varej nga përfaqësitë ushtarake apo diplomatike gjermane të Juglindjes, por drejtpërdrejt nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, së cilës i dërgonte raporte të drejtpërdrejta. Ai kishte një shtab të tijin, me të cilin bashkëvepronte (Scheigerstelle).<sup>8</sup>

Megjithatë për Ribbentropin, këto emërimë ishin të pamjaftueshme për të fituar kohën e humbur në drejtim të politikës gjermane ndaj Shqipërisë, dhe të njohjes të situatës së saj. Për këtë qëllim ai i caktoi detyrë të posaçme përfaqësuesit gjerman në Shqipëri, Schliep, që të konsultohet me ambasadorin gjerman në Romë, Mackensen, për të siguruar informacione të plota dhe të besueshme për Shqipërinë. Midis të tjerave, Ribbentropi shtroi nevojën e marrjes së një vendimi politik mbi qëndrimin e ardhshëm të Gjermanisë ndaj Shqipërisë. Më tej, ministri i Jashtëm Gjerman, në planin e tij sqaronte se, “në rastin e mbrojtjes ushtarake të bregdetit Adriatik shqiptar, të qetësojmë politikisht Shqipërinë, që trupave gjermane t’u lehtësohet mbrojtja e kësaj, d.m.th. që, sipas mundësisë të mos ketë nevojë të përdoren kurrfarë forcash ushtarake gjermane, ose vetëm forca të vogla, për mbrojtjen e qetësisë

<sup>6</sup> Christoph Stamm, *Zur deutschen Besetzung Albaniens (1943-1944)*, Militärgeschichtliche Mitteilungen, 2 (Bd 2, 1981), f. 102.

<sup>7</sup> B. Kühmel, *vep. e përm.*, f. 141.

<sup>8</sup> Politische Archive (PA) Staatssekretär, Albanien, Bd-1. Letra e Frovajnit (Vrohovein) dërguar Komandës Supreme të Vermachtit, nr. 1902, Berlin, 8.09.1943.

dhe rendit në Shqipëri dhe rrugët afruese për furnizimin e trupave tona që do të luftonin në bregun e detit, të jenë plotësisht të siguruar”.<sup>9</sup>

Mbështetur në informacionin e ngjeshur të Schliepit për ministrin e Jashtëm gjerman, u skicua dhe koncepti i politikës gjermane për Shqipërinë. Për të përvijuar këtë politikë Ribbentropi kishte në konsideratë dhe vlerësimin e Komandës së Lartë ushtarake gjermane për rëndësinë e Shqipërisë në pikëpamje strategjike, për ta mbrojtur atë nga një sulm i mundshëm aleat. Por, nga ana tjetër, kishte parasysh dhe mungesën e trupave të nevojshme për një pushtim tradicional. Kujtojmë, këtu se ushtria gjermane kishte marrë goditje të mëdha në Frontin e Lindjes. Ajo nuk ishte tashmë në apogjeun e fuqisë së saj, por ishte në rënie të vazhdueshme. Fuqitë Aleate Antifashiste kishin goditur fort “Perandorinë fashiste” në frontin e Mesdheut, duke hyrë thellë në Italinë e Jugut.

Sugjerimi i qendrës së politikës gjermane, për veprim në Shqipëri, ishte që Schliepi të ndihmonte në përgatitjen e planeve për ndërtimin e një Shqipërie të pavarur e asnjansë, të qeverisur nga një qeveri që të ishte miqësore ndaj Gjermanisë.<sup>10</sup> Me fjalë të tjera, ky koncept i politikës gjermane diktohej nga fakti se, Komanda e Përgjithshme e Vermahtit e kishte bërë të qartë, se s’kishte forca të mjaftueshme ushtarake dhe policore për të penguar rritjen e lëvizjes partizane. Ndaj, kjo mungesë duhej kapërcyer me metodën e qetësimit dhe të kënaqjes politike dhe ekonomike të aleatëve gjermanë të Ballkanit”.<sup>11</sup> Konsiderata të tilla të Vermahtit i përshtateshin Shqipërisë duke e vlerësuar atë si aleat natyral. Sipas Shtabit Operativ të Vermahtit, “shqiptarët ende anonin kah Gjermania. Ata dëshirojnë pavarësinë e vet shtetërore. Ai që do t’ua sillte këtë është mik i tyre. Duhet pritur në se anglo-amerikanët, në rastin e parë të volitshëm, do të shpallin pavarësinë shqiptare. Për këtë shkak, duket nevojë e ngutshme që, nga ana gjermane, të jepet me kohë një deklaratë e tillë, d.m.th. para anglo-amerikanëve, për t’u penguar shqiptarët, që të mos shkojnë në anën e armiqve”<sup>12</sup> (kupto: të anglo-amerikanëve).

<sup>9</sup> Po aty. Telegram i shifruar i Ribbentropit dërguar Ambasadës Gjermane në Romë, nr. 3388, 21.08.1943.

<sup>10</sup> B.J. Fischer, *vep. e për.*, f. 216.

<sup>11</sup> Anatomie der Aggression. Neue Dokumente zu den Kriegszielen der faschistischen deutschen Imperialismus im Zweiten Weltkrieg. Herausgegeben und eingeleitet von Gerhard Hass und Wolfgang Schumann, Berlin, 1972, dok.nr. 72.

<sup>12</sup> Po aty, f. 198.

Në zbatim të sugjerimeve të marra nga ministri i Jashtëm gjerman, pasi vlerësoi, sipas tij, mentalitetin e shqiptarëve si progjerman, në ndryshim me urrejtjen që kishin fituar ata ndaj pushtuesit italian, Schliep, arrinte në përfundimin se, ai duhej të merrej me çështjen e një qeverie shqiptare, e cila të ishte në mbështetje të zgjidhjes së detyrave strategjike gjermane. Diplomati gjerman Schliep, konstatonte se, qeveritë e mëparshme në Shqipëri ishin të komprometuara, për shkak të pozitës bashkëpunuese të tyre ndaj Italisë. Prandaj, ky variant i aktivizimit të politikanëve shqiptarë proitalianë përjashtohej nga axhenda e punës së Schliepit. Kështu, u përjashtuan bisedimet me Eqrem Libohovën, kryeministër i kompromentuar plotësisht me italianët. Gjithashtu, gjatë punës së tij, Schliep përjashtoi dhe bisedat me Lëvizjen Nacional-lirimtare, duke pasur parasysh ndikimin e komunistëve në këtë lëvizje.

Bindja e Schliep-it ishte se në Shqipëri nuk kishte njerëz me cilësitë e duhura të drejtuesit që të gëzonin autoritet dhe popullaritet e të mos kishin pasur lidhje me italianët.<sup>13</sup> Prandaj mendimi i Schliep-it ishte se, gjermanët mund të mbështeteshin më mirë te politikanët kosovarë, të cilët, ai i quante shqiptarë më besnikë. Këtë bindje ai e mbështeste në faktin se, kosovarët ishin mirënjohës të gjermanëve, se i kishin shpëtuar nga zgjedha shoviniste serbe dhe ishin bashkuar me Shqipërinë. Me këtë arsyetim, pothuajse, bashkohej edhe Neubacheri. Ai shprehej se kosovarët ishin më të bashkuar politikisht dhe ushtarakisht, pasi ata kishin një bindje se do të fitonin ose do të humbisnin bashkë me Gjermaninë. Pikërisht, për këto cilësi e veti të politikanëve shqiptarë të Kosovës, Neubacheri arrinte në përfundimin se, kosovarët ishin të dobishëm për të qeverisur Shqipërinë.<sup>14</sup> Ndoshta, pikërisht për këtë arsye, takimin e parë në Beograd Neubacheri e kishte realizuar me Xhafer Devën, i cili ishte treguar i gatshëm për bashkëpunim. Gjithashtu, Neubacheri, kishte biseduar për këtë qëllim, edhe me Vehbi Frashërin, i biri i Mehdi Frashërit, i cili në atë kohë ishte i internuar në Itali.<sup>15</sup> Takimet me Xhafer Devën dhe Vehbi Frashërin, Neubacheri i bëri para se të nisej për në Tiranë.

---

<sup>13</sup> Captured German Records (National Archives), SHBA (Dokumente gjermane të kapura nga Aleatët, CGR, Ruli T 120/340, N.4893, Tiranë, Schliep për RAM, 23 gusht 1943. (Cituar sipas B.J. Fischer, *vep e për.*).

<sup>14</sup> Po aty, T 120/340, N. 942, Tiranë, Neubacher, 12 shtator 1943.

<sup>15</sup> Hermann Neubacher, *Sonderauftrag Südost, 1940-1945*, Bericht eines fliegenden Diplomaten, Göttingen; Musterschmidt Verlag, 1956, f.106.

Më 10 shtator të vitit 1943, menjëherë pas shpalljes së kapitullimit të Italisë, Neubacheri u nis në drejtim të Shqipërisë. Para tij, në Shqipëri ishte dërguar një repart prej 60 ushtarësh të Abverit, të Divizionit të Dytë, “Brandenburg”, të cilët do të bashkëvepronin me një regjiment parashutistësh që, tashmë, ishin stacionuar në Shqipëri.

Veprimtaria e Neubacherit, pas ardhjes në Tiranë, synonte në angazhimin e nacionalistëve shqiptarë, për luftë kundër komunistëve ose Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe në fortifikimin e bregdetit Adriatik, për një mbrojtje të suksesshme, në rastin e zbarkimit të Aleatëve. Ai, tashmë, do të zbatonte vijën e politikës gjermane, që ishte përshtatur të zbatohet ndaj Shqipërisë. Neubacheri kishte vendosur që të paraqitej para nacionalistëve shqiptarë me alternativën e pavarësisë shqiptare, duke shprehur dëshirën e demonstrimit para tyre si çlirimtar i Shqipërisë nga pushtimi italian. Njëherazi, me këtë rast, linte të kuptohet se, Gjermania do të merrte meritën e rivendosjes së pavarësisë dhe të sovranitetit të shtetit shqiptar. Si përfaqësues i Gjermanisë, Neubacheri mori përsipër përgjegjësinë që, deri në mbarim të luftës, të ruheshin vijat e demarkacionit, të vendosura më parë nga marrëveshjet midis Italisë dhe Bullgarisë. Me fjalë të tjera, Gjermania bëhej garante e ruajtjes së kufijve ekzistues të Shqipërisë.

Në emër të zbatimit të qëllimeve politike të Gjermanisë në Juglindje, Neubacheri ishte këmbëngulës që ndaj trevave shqiptare, të cilat kishin qenë nën pushtimin italian, të vendosej një maksimum qeverisjeje nga vetë ata dhe të hiqej dorë nga çdo angazhim i plotë i organeve ushtarake-administrative gjermane. Një politikë e tillë nënkuptonte, që, me një skemë normale të aparatit ushtarak-administrativ të pushtimit, të mos i bëhej dëm parullës politike të shpalosur mbi Shqipërinë e pavarur.<sup>16</sup>

Megjithëse politika gjermane kishte parashtruar një plan joshës në përputhje me strategjinë e nacionalistëve shqiptarë, që aspironin pavarësinë e plotë kombëtare, përfaqësuesit gjermanë në Shqipëri, kishin vënë re se populli kishte marrë një qëndrim shumë të rezervuar ndaj gjermanëve. Në raportin e Neubacherit për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, theksohej se, “popullsia shqiptare nuk qe e

---

<sup>16</sup> H. Neubacher, *vep. e për.*, f. 106-107.

befasuar nga kapitullimi i Italisë dhe nuk ka treguar gatishmëri për bashkëpunim me Gjermaninë”.<sup>17</sup>

Ky skepticizëm i shqiptarëve e kishte bazën në zhvillimin jo të favorshëm të luftës për gjermanët, në atë kohë, të raporteve luftarake në frontet e luftës botërore, e cila krijonte pasiguri e dyshime të thella mbi fatin e boshtit fashist, se ai do ta humbiste luftën. Duhet thënë se, kapitullimi i Italisë e kishte përforcuar ndër shqiptarët dyshimin e humbjes edhe për aleaten e saj, Gjermaninë.

Mbështetur në këtë situatë të ndërlikuar politike, të paskapitullimit të Italisë, përpjekjet gjermane për të tërhequr shqiptarët, për një bashkëpunim me ta, duke nxitur ndjenjat kombëtare të tyre dhe duke hedhur parullën për rivendosjen e pavarësisë shqiptare, ndeshi në hezitime tek politikanët atdhetarë shqiptarë. “Shihej qartë, - shprehej Schliep, - se këta njerëz brengoseshin më tepër se për çdo gjë, që marrëveshja me Gjermaninë, para se të ngadhënjejë aleatja (Gjermania – M.D.), të cilën ata e konsideronin të afërme, të mos rrezikojnë sigurinë e tyre personale, pasurinë si dhe interesat e vendit”.<sup>18</sup> E vërteta është se të gjitha rreziqet që përmendëm, për politikanët shqiptarë, ekzistonin. E ardhmja e këtyre të fundit, rrjedhimisht, do të ishte e lidhur me fatin që do të kishte Gjermania në fund të luftës. Sidoqoftë, personalitetet intelektuale shqiptare, që bisedonin me përfaqësues të politikës gjermane, për të ardhmen e Shqipërisë pas kapitullimit të Italisë, niseshin më tepër nga interesat e vendit, se sa për sigurinë personale dhe pasurinë e tyre. Më shumë se sa për fatin e tyre personal, shumë intelektualë shqiptarë hynë në bisedime për të forcuar rolin e shtetit shqiptar në funksionet e tij të brendshme, me bindjen se funksionet e jashtme të tij, në situatë lufte do të ishin pa ndonjë peshë për ndryshimin e fatit të luftës midis dy blloqeve të mëdha ndërluftuese. Në bisedimet e bëra me përfaqësues të politikës gjermane, personalitetet shqiptare kishin marrë garanci jo vetëm për mbështetje të ruajtjes së qetësisë së brendshme, por edhe premtimin për t’iu bashkuar shtetit shqiptar ato treva shqiptare që kishin mbetur jashtë kufirit të saj deri në shtator të vitit 1943. Me fjalë të tjera, Gjermania paraqitej si çlirimtare e Shqipërisë nga pushtuesit italianë, si një shtet që synonte të realizonte ribashkimin e shtetit shqiptar në trojet e

<sup>17</sup> Akten zur deutschen auswärtigen Politik, Serie E (më tej: ADAP,E). Bd. VI, dok. Nr. 316. Telegram i Neubacherit, dërguar MPJ, nr. 942, Beograd, 12.09.1943.

<sup>18</sup> PA, Staatssekretär, Albanien, Bd.1. Telegram i konsullit të përgjithshëm Schliep për MP Jashtme, nr. 33, Tiranë, 10.09.1943.

veta etnike, e cila do të zinte rreth 74 mijë km<sup>2</sup>, të banuara me shumicë shqiptare<sup>19</sup>. Disa autorë do ta vlerësonin realizimin e aspiratës së shqiptarëve për një shtet kombëtar (brenda kufijve etnikë), si një realizim pervers<sup>20</sup>, nisur nga koha në të cilën bëhej një gjë e tillë, kur Europa ishte mbërthyer në makthin e luftës. Një arsyetim i tillë bëhej duke shpërfillur interesat e shqiptarëve, të cilët, edhe pse ishin afishuar në luftën kundër fashizmit, në anën e Aleatëve të Mëdhenj Antifashistë, nuk kishin marrë ende asnjë garanci për fatin e Shqipërisë në fund të luftës.

Qëndrimi inert i aleatëve ndaj fatit të shqiptarëve në fund të luftës, në një moment kyç të zhvillimit të ngjarjeve politike e ushtarake në Shqipëri, ndikoi tek nacionalistët shqiptarë për ngjalljen e shpresës së krijimit të shtetit kombëtar nga premtimet e gjermanëve.

Duke analizuar këto rrethana të Shqipërisë, pas kapitullimit të Italisë fashiste, Reginald Hibberti ka arritur në përfundimin, sipas të cilit, “e vetmja arsye, e cila ndoshta do të mund ta ngrinte gjithë popullin shqiptar për të rezistuar me vendosmëri dhe për të përballuar terrorin gjerman, do të ishte pranimi i hapur nga aleatët për ta bërë të përherëshme Shqipërinë e Madhe (kupto: Shqipërinë Etnike-M.D.). Kjo, - vërente Hibbert - ishte e pakonceptueshme për qeveritë aleate, të cilat kishin angazhime për fqinjët e Shqipërisë”.<sup>21</sup> Dhe këto angazhime ishin në dëm të Shqipërisë, të cilat synonin t’i shkëputnin asaj dhe territore të tjera, për të kënaqur fqinjët.

Megjithatë, kujdesi i gjermanëve për të gjetur njerëz të përshtatshëm, tek të cilët të ekzistonte bindja se kanë prirje progjermane, ishte i vazhdueshëm. Hapi i parë i aksionit gjerman, në bisedat e tyre me personalitetet shqiptare progjermane, ishte që t’i bindnin ata, të krijonin një organizëm shqiptar, që do të shpallte pavarësinë e Shqipërisë, menjëherë pas kapitullimit të Italisë.

Sipas udhëzimeve që kishte marrë Neubacheri nga qeveria gjermane, ai do të bënte kujdes të veçantë, për të sqaruar miqtë e tij shqiptarë, që duhej ta merrnin vetë iniciativën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ndërkohë jepej garancia për gatishmërinë e Gjermanisë për ta njohur pavarësinë e Shqipërisë si dhe mbrojtjen e saj. Qeveria shqiptare

---

<sup>19</sup> Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f. 22; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë: “Toena”, 1997, f. 37.

<sup>20</sup> R. Hibbert, *vep. e përm.*, f. 22.

<sup>21</sup> Po aty, f. 22-23.

që do të formohej, do të njihej nga Gjermania. Kjo qeveri, në bazë të një marrëveshjeje me forcat e armatosura gjermane, do të ruante interesat e popullsisë.<sup>22</sup>

Qëndrimi i rezervuar i personaliteteve në Shqipëri, i orientoi përfaqësuesit gjermanë që për veprimin politik, të kthenin vështirimin për bashkëpunim të figurat e volitshme në Kosovë. Ndër ta, njeriu më besnik i tyre ishte Xhafer Deva.<sup>23</sup> Kështu, menjëherë pas kapitullimit, u përcaktuan qartë për bashkëpunim, veç Ibrahim Biçakut dhe Vehbi Frashërit, edhe Xhafer Deva, të cilët, bënë përpjekjet e para për krijimin e Komitetit Kombëtar, i cili do të zgjidhte një Komitet Ekzekutiv të Përkohshëm. Secili prej tyre përpiquej të gjente bashkëpunëtorët e vet. Ndërkohë, ata vepronin për të arritur formimin e Komitetit Kombëtar, nën trysinë e Neubacherit, i cili u kujtonte se, në të kundërt, “qeveria e Gjermanisë do të detyrohej të vendoste sistemin pushtues”<sup>24</sup> me të gjitha pasojat e tij për Shqipërinë.

Konsultimet politike të grupeve të Biçakut dhe të Devës dhanë si rezultat bashkimin e tyre, më 14 shtator 1943, duke formuar Komitetin Kombëtar, nën drejtimin e Ibrahim Biçakut. Komiteti Kombëtar krijoi një Komitet Ekzekutiv, si një organ më i ngushtë prej 5 anëtarësh, i cili do të luante funksionet e Qeverisë së Përkohshme në administrimin e vendit. Në Komitetin Ekzekutiv të Përkohshëm bënë pjesë: Bedri Pejani, Xhafer Deva, Vehbi Frashëri, Mihal Zallari, Eqrem Telhaj.

Pas formimit të Komitetit Kombëtar dhe të Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm, qeveria e Eqrem Libohovës, paraqiti dorëheqjen. Në këto rrethana, kur ende nuk ishte formuar qeveria e re, ministritë udhëhiqeshin përkohësisht nga sekretarët e përgjithshëm.

Shpallja e Pavarësisë nga Komiteti Kombëtar, me sa duket, u bë me pëlqimin e Neubacherit<sup>25</sup>. Mbi këtë bazë, u hartua dhe teksti i njohjes së pavarësisë së Shqipërisë nga qeveria gjermane, i cili iu dorëzua Komitetit Kombëtar më 24 shtator 1943. Sipas kujtimeve të Neubacherit del se, ky i fundit, kishte bërë kujdes të veçantë që dokumenti i njohjes së pavarësisë

<sup>22</sup> PA, Staatssekretär, Albanien, Bd.1. Telegram i konsullit të përgjithshëm Schliep për MP Jashtme, nr. 33, Tiranë, 10.09.1943.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> H. Neubacher, *vep. e përm.*, f. 109.

<sup>25</sup> PA, Staatssekretär, Albanien, Bd.1. Telegram i këshilltarit të Legatës, Steg, për MP Jashtme, zyrës së ministrit, nr. 1466, 19.09.1943, ku përfshihet dhe raporti i Neubacherit.

të kishte një karakter solemn zyrtar. Nota e qeverisë gjermane për njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur, kishte këtë përmbajtje:

“Qeveria e Rajhut përshëndet vendimin e patriotëve shqiptarë që, pas ndërprerjes së çdo legaliteti dhe vazhdimësie, për shkak të ngjarjeve të fundit, të marrin mbi vete përgjegjësinë për udhëheqjen e shtetit shqiptar në bazë të pavarësisë së Shqipërisë. Qeveria e Rajhut njeh Këshillin Ekzekutiv, të emëruar më 15 shtator nga ana e Komitetit Nacional, i cili ka marrë mbi vete punët e qeverisë së Shqipërisë.

Qeveria e Rajhut u vu në dijeni se Asambleja, për të cilën po bëhen përgatitje, në bazë të pavarësisë së shtetit shqiptar, do të nxjerrë vendime autonome mbi rregullimin politik të Shqipërisë dhe do të emërojë qeverinë definitive”.<sup>26</sup> Mbështetur në këtë formulë njohjeje të autoritetit qeverisës të shtetit shqiptar, mund të thuhet se, kemi të bëjmë me një dokument të mirëfilltë të karakterit diplomatik në marrëdhëniet midis dy vendeve. Me këtë dokument afirmohej pavarësia e Shqipërisë, në rrethanat e Luftës Botërore. Mbështetur në këto rrethana lufte qeveria shqiptare do të nxirrte vendime autonome mbi rregullimin politik të Shqipërisë, sipas të cilave qeveria shqiptare të realizonte funksionet ekzekutive të shtetit.

Në kancelarinë gjermane ishte menduar dhe personi që do të luante “rol të veçantë” në kohën e formimit të qeverisë shqiptare. Autoritetet gjermane kishin evidentuar emrin e Mehdi Frashërit. Ai nuk ishte komprometuar si bashkëpunëtor i Italisë. Përkundrazi, autoritetet e pushtimit, e kishin internuar në Itali, nën mbikqyrje të përhershme të policisë. Veç të tjerave, ai vlerësohej për përvojën shumëvjeçare si funksionar shteti, gjë që u jepte besim gjermanëve për kandidaturën e tij.

Gjermanët shpresonin shumë në personin e Mehdi Frashërit, si antiitalian me përvojë, i cili do të tërhiqte rreth vetes bashkëpunëtorë të aftë e të vendosur, për funksionimin e organeve shtetërore shqiptare.

Konsulli i përgjithshëm gjerman në Romë, Vynster, mori detyrën, për ta takuar Mehdi Frashërin dhe për ta përcjellë në Tiranë tek Neubacheri, Scheigeri ose tek konsulli i përgjithshëm Schliep.<sup>27</sup>

Mehdi Frashëri pranoi të bashkëpunonte me gjermanët, pasi u shpall Pavarësia e Shqipërisë me kufijtë që kishte asokohe. Më 17 shtator

<sup>26</sup> ADAP,E, Bd VI, dok. Nr. 329; H. Neubacher, *vep. e për.*, f. 111.

<sup>27</sup> PA, Staatssekretär Bd.1. Telegram i Riterit dërguar konsullit në Romë, Vynsterit, nr. 11, Berlin, më 12.09.1943.

1943 ai zbriti me aeroplan në Tiranë<sup>28</sup> dhe mbajti lidhje të vazhdueshme me funksionarët gjermanë në Shqipëri, Schliep, Scheiger dhe Neubacher.

Me gjithë përpjekjet që ishin bërë nga gjermanët e pranishëm në Shqipëri, nuk ishte e vështirë të kuptohej se ende ekzistonte një situatë e pafavorshme për Gjermaninë dhe planet e saj. Në raportet e Neubacherit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, “konstatoheshin ende shenja të vlerësimit të pavolitshtëm të situatës ushtarake gjermane nga ana e shqiptarëve të vjetër (është fjala për shtetin shqiptar të paraluftës – MD), sidomos nga popullsia e qyteteve, e cila llogarit në qëndrimet e saj një aksion të afërm të aleatëve në Shqipëri”. Këtë qëndrim të rezervuar ndaj gjermanëve, për rrjedhojë dhe të përkrahjes së pakët publike të Komitetit Kombëtar, e mbanin edhe nacionalistët shqiptarë që kishin luftuar pushtuesin italian.

Prandaj, Mehdi Frashëri, në përpjekje për të zgjeruar rrethin e mbështetësve në misionin e tij, iu desh të mbante një qëndrim të kujdesshëm ndaj tyre. Duke iu referuar kësaj kategorie personash, Neubacheri nënkuptonte, së pari, zogistët. Për momentet e asaj situatë politike, një qëndrim i rezervuar ndaj gjermanëve, u shkonte për shtat nacionalistëve, prandaj Neubacher shprehej për Abaz Kupin: “Ne atë e kemi lënë në qetësi dhe ai neve”.<sup>29</sup>

Dilema dhe situata e mëdyshjes së nacionalistëve që anonin në bashkëpunimin me Komitetin Ekzekutiv të Përkohshëm dhe për rrjedhojë dhe me gjermanët, u kthjellua në fillim të tetorit 1943. Moszbarkimi i paralajmëruar disa herë, i Aleatëve në Shqipëri, i çliroi nacionalistët shqiptarë nga dilema e mëdyshjes, në qëndrimin dhe orientimin e tyre në ato rrethana historike. Kontaktet e organeve politike dhe informative gjermane me grupet e armatosura nacionaliste shqiptare u intensifikuan.

Për sa i përket Ballit Kombëtar, i cili ishte afishuar hapur kundër pushtimit të Italisë në Shqipëri, u shpreh i gatshëm të bashkëpunonte me gjermanët. Pozicionimi i hapur i Lëvizjes Nacionalçlirimtare kundër Ballit Kombëtar, në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të Labinotit (4-9 shtator 1943), duke hedhur poshtë Marrëveshjen e Mukjes, të gushtit 1943, i imponoi Ballit Kombëtar një qëndrim afrimi me gjermanët. Në kushtet e shpalljes së luftës civile për marrjen e pushtetit nga ana e

<sup>28</sup> Po aty. Telegram i ambasadës gjermane në Romë (Vynster), nr.18, dt. 15.09.1942 dhe nr. 37, datë 18.09.1943.

<sup>29</sup> H. Neubacher, *vep. e për.*, f. 108.

Lëvizjes Nacionalçlirimtare, nën udhëheqjen e PKSh, Balli Kombëtar, në mënyrë të detyruar, e orientoi luftën kundër komunistëve si një rrezik që çonte jo vetëm në asgjësimin e vetë organizatës, por edhe si rrezik për të ardhmen e Shqipërisë.

Duhet thënë se vendimi i Ballit Kombëtar, i organizmave drejtuese të tij, për të kaluar në fazën e veprimit të përbashkët me trupat gjermane kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare<sup>30</sup>, erdhi pas shumë përpjekjesh e tratativash me udhëheqjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për ta evituar këtë përplasje midis tyre. Vetëm pasi u konsumuan të gjitha përpjekjet, u mor vendimi fatal për të kundërvepruar ndaj sulmeve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, që shënoi dhe fillimin e luftës civile midis shqiptarëve me përkatësi politike të ndryshme.

Në përputhje me strategjinë e tyre, për sigurimin e një lëvizjeje të qetë në rrugët e furnizimit me materiale, gjermanët kishin rënë në kontakt dhe me kleret katolikë të Mirditës. Me ta ishin bërë bisedime në Shkodër në fillim të tetorit 1943.<sup>31</sup>

Pas ardhjes së gjermanëve në Shqipëri, problem kryesor për ta, ishte raporti që do të vendosnin me trupat italiane, që kishin shpallur kapitullimin. Këto marrëdhënie do të përcaktoheshin nga qëndrimi i italianëve ndaj tyre, nëse do të bashkëpunonin me ta apo do të luftonin kundër tyre.

Badoglio, që erdhi në krye të qeverisë italiane pas Musolinit, nuk dha urdhëra të qarta për mënyrën e veprimit të ushtrisë italiane pas kapitullimit. Armata e 9-të italiane, që vepronte në Shqipëri, e drejtuar keq, u la mundësi oficerëve të interesoheshin vetëm për të shpëtuar. Njëherazi, në masën e ushtarëve italianë, ishte përhapur frikë dhe panik për egërsinë e ushtrisë gjermane. Kjo situatë shkaktoi një kaos të përgjithshëm, kur ishte i vështirë orientimi. Në këto rrethana u gjend Shqipëria pas kapitullimit të Italisë, në radhë të parë, forcat politike ndërluftuese të saj.

Masat që kishin marrë gjermanët, në prag të kapitullimit të Italisë, duke vendosur paraprakisht trupa në Shqipëri, dhe situata kaotike pas kapitullimit, u dha mundësi gjermanëve të shtriheshin relativisht lehtë e të vendoseshin në qendrat kryesore të vendit. Tre divizionet e

---

<sup>30</sup> PA, Staatssekretär, Albanien, Bd. 1. Telegram i Neubacherit dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, nr. 1133, Beograd, 8.10.1943.

<sup>31</sup> Po aty.

Korparmatës XXI gjermane, nën komandën e gjeneralit Hubert Lanz, u futën në Shqipëri më 9 shtator 1943. Ata ndeshën në një qëndresë minimale të 9 divizioneve italiane të përqendruara në Shqipëri. Ata nuk u penguan edhe nga goditjet e grupeve të ndryshme të rezistencës shqiptare. Nga 9 deri 11 shtator 1943 trupat gjermane u vendosën në Prishtinë, Prizren, Strugë, Elbasan, Pogradec, Tiranë, Durrës, Kukës, Vlorë, Tepelenë etj. Në vartësi të sjelljes së trupave italiane, u përcaktua dhe mënyra e veprimit të trupave gjermane ndaj tyre. Kur ato nuk pranonin të dorëzoheshin tek gjermanët, mbi forcat italiane ushtroheshin masakra e raprezalje nga forcat gjermane. Kështu ndodhi me divizionin italian “Peruxhia”, në mesin e shtatorit 1943, i cili nuk pranoi t’u dorëzohej gjermanëve në Sarandë.

Krahas vendosjes të trupave gjermane në qendrat kryesore të Shqipërisë, vazhdonte edhe veprimtaria politike për ngritjen e organeve qeverisëse, të përbëra nga personalitete shqiptare, të pakomprometuara më parë.

Të gjitha marrëdhëniet me shqiptarët, pas formimit të organeve qeverisëse shqiptare, do të drejtoheshin nga Schliep, i cili u emërua ambasador i Gjermanisë në Shqipëri. Megjithatë, dora e Neubacherit ndjehej e pranishme në të gjithë procesin politik që zhvillohej në Shqipëri.

Pasi i kishte rregulluar punët me njerëzit që kishin pranuar të bashkëpunonin, Neubacher u largua nga Tirana, për t’i lënë shqiptarët të vepronin dhe të krijonte imazhin se po bënin gjithçka vetë.<sup>32</sup> Më 14 shtator 1943, u mblodh një Komitet Kombëtar prej 22 vetash, i kryesuar nga Bedri Pejani, i cili ngarkoi të ushtronte pushtet ekzekutiv Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, i përbërë prej 6 vetash nën drejtimin e Ibrahim Biçakut.

Vendimi i parë që ndërmoi Komiteti Kombëtar, pasi iu referua historisë së Shqipërisë deri në atë çast, ishte të shpallte fundin e zgjedhës italiane në Shqipëri. Njëherazi ai bëri thirrje për krijimin e një qeverie përfaqësuese. Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, që do të luante këtë rol, ndërmoi hapin tjetër politik, duke bërë thirrje për zgjedhjen e një Asambleje Kushtetuese Kombëtare, që do të hartonte kushtetutën dhe do

---

<sup>32</sup> H. Neubacher, *vep. e përm.*, f. 109.

të zgjidhte qeverinë e re të Shqipërisë. Thirrja për këtë u botua në shtypin e kohës.<sup>33</sup>

Gjatë veprimtarisë së shkurtër njëmuajore, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm nxori urdhra, vendime e dekrete, të cilat kishin për qëllim, të normalizonin jetën e vendit, në vakuumin institucional të krijuar, deri në formimin e qeverisë. Duke e përmbledhur misionin e Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm, kryetari i tij, Ibrahim Biçaku, do të vinte në dukje se, “Komiteti Kombëtar nuk bani një trimni, por kreu një detyrë kombëtare. Përpara çdo gjëje tjetër, ay asht përpjekun ta rivendosi bashkimin e shenjtë që duhet të mbretnojë sod midis gjithë bijve të këtij kombi, në këto çaste rreziku të jashtëm e të brendshëm ... se detyra themelore e çdo shqiptari asht me ia shtri dorën njani-tjetrit dhe anmikut për shpëtimin e Atdheut”.<sup>34</sup>

Formimi i Komitetit Ekzekutiv dhe veprimtaria e tij ishte një zgjedhje praktike në situatën e paskapitullimit të Italisë. Urdhëresat dhe vendimet e Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm kishin të bënin me suprimimin e detyrës së këshilltarëve italianë, pranë ministrive, drejtorive të përgjithshme shtetërore, të krijuara me Dekretin Mëkëmbësor, datë 2.6.1939.

Një urdhëresë e veçantë kishte të bënte me funksionimin e bankës, që t’u vihej fre spekulimeve që mund të bëheshin nëpërmjet saj. Edhe gjykatat shqiptare do t’i jepnin tashmë, vendimet në emër të shtetit shqiptar, dhe jo të mbretit italian. Me një vendim të Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm rrëzoheshin dispozitat e Dekretit, datë 11.12.1939, mbi bashkimin e Fuqive të Armatosura Shqiptare me Fuqitë e Armatosura Italiane, duke rikthyer Kodin Penal Shqiptar dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret e dhëna për ushtrinë shqiptare që kishin funksionuar përpara datës 7 prill 1939.

Një vendim i rëndësishëm i Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm/Nr. 60, datë 21.09.1943, ishte “Rrëzimi i Konventës italo-shqiptare”, të 20 prillit 1939, sipas së cilës barazoheshin të drejtat civile e politike të qytetarëve shqiptarë në Itali dhe atyre italianë në Shqipëri.<sup>35</sup>

Vendimi i 21 shtatorit 1943 që deklaroi të rrëzuar akordin e 3 qershorit 1939 mbi unifikimin e shërbimit diplomatik e konsullor, pati

<sup>33</sup> Gazeta *Kombi*, 19 shtator 1943.

<sup>34</sup> Bisedimet e Kuvendit Kombëtar (16 Tetuer – 10 Nanduer 1943), Tiranë, 1944, f. 7. Fjala e Ibrahim Biçakut në mbledhjen e parë, 16 tetor 1943.

<sup>35</sup> Po aty, f.30-32.

një rëndësi të madhe për pozitën e shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky vendim ishte një masë që pavarësonte shtetin shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Me vendimin nr. 62, datë 21.09.1943, që shfuqizonte Dekretin nr. 101 të 3 prillit 1940, mbi krijimin dhe atributet e Këshillit të Epërm Fashist Korporativ, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm i shpalli luftë hapur ideologjisë fashiste, duke e ndaluar përhapjen e saj në Shqipëri.<sup>36</sup>

Gjatë veprimtarisë së Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm, dolën urdhra të posaçme për vendosjen e rregullave për marrëdhëniet me ushtrinë italiane, të kapitulluar sidomos, për ato çështje që kishin të bënin me shkëmbimet e shitjet që do të bënte ajo në Shqipëri.

Rivendosja e rregullave të qarta synonte t'u jepte goditje spekulimeve në fushën ekonomike dhe zhvillimin e një jete ekonomike normale.<sup>37</sup> Në rrethanat e një situatë kaotike, kishte rrezik rrëshqitja në anarki, e cila ishte me pasoja të rënda.

Më 23.09.1943 Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, nënshkroi Dekretin për mbledhjen e Asamblesë Kombëtare.<sup>38</sup> Në të pesë nenet e këtij Dekreti përcaktoheshin qartë mënyrat e zgjedhjes së kandidaturave për në Asamblenë Kombëtare. Në rrethanat e Luftës Botërore, nuk mund të pretendohesh për një përfaqësim të përgjithshëm. Prandaj, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm kishte kompetencën për të ftuar në Asamblenë Kombëtare përfaqësues të klerit shqiptar si dhe personalitete të shquara nga bota politike shqiptare. Në këtë mënyrë përfaqësimi do të ishte më i mundshëm, në ato rrethana.

Me një vendim të posaçëm (nr. 117, datë 27.09.1943) Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm abrogoi Dekretin Mëkëmbësor Nr. 86, datë 14 shkurt 1940, mbi ndryshimin e pozitës kushtetuese të këshillave administrativë të prefekturave, nënprefekturave, të komunave e të bashkive. Njëherazi, u vunë në fuqi ligjet e Administratës Civile të periudhës së Mbretërisë Shqiptare. Mbështetur në këto ligje rivendoseshin në administratë ato persona që ndodheshin të ngarkuar në detyrë deri më datë 7 prill 1939<sup>39</sup>.

---

<sup>36</sup> Po aty, f. 33.

<sup>37</sup> Po aty, f. 34.

<sup>38</sup> Po aty, f. 35. Dekret, datë 23.9.1943, nr.112. Mbi mbledhjen e Asamblesë Kombëtare.

<sup>39</sup> Po aty, f. 37. Vendimi nr. 117, datë 27.09.1943.

Rreth 250 vendime, urdhëresa e dekrete që dolën nga Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, gjatë afro një muaji, duke shfuqizuar akte e dekrete ligjore të shtetit italian, të cilat zbatoheshin edhe në Shqipëri gjatë pushtimit, dëshmojnë për një veprimtari të ngjeshur në fushën e qeverisjes së shtetit shqiptar. Në mënyrë të padiskutueshme, ato akte ligjore e administrative, ndërprejnë lidhjet me pushtuesin italian dhe hapën siparin e funksionimit të shtetit shqiptar në bazën e ligjeve të paraluftës, ndonëse nuk u mor ndonjë akt i cilësuar për rivendosjen e sovranitetit të shtetit shqiptar të paraluftës.

Të gjitha vendimet, urdhrat e dekretet që nxori Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, iu nënshtuan për miratim ligjor Kuvendit Kombëtar në mbledhjen IV të 21 tetorit 1943, të cilat përbënin një çështje të veçantë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.<sup>40</sup>

Pas zgjedhjeve të delegatëve nga të gjitha prefekturat e vendit, sipas Dekretit që ishte miratuar, më 16 tetor 1943, u hap seanca (mbledhja) e parë e Kuvendit Kombëtar. Kjo seancë zgjati vetëm 30 minuta. Për drejtimin e mbledhjes së parë u caktua Lef Nosi, kryetar dhe Xhelal Mitrovica, sekretar.<sup>41</sup>

Në mënyrë të përmbledhur, Ibrahim Biçaku paraqiti punën dhe misionin që kishte realizuar Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, duke vënë theksin në situatën e ndërlikuar të paskapitullimit të Italisë. Kryefjala e gjithë fjalimit të tij ishte bashkimi i shqiptarëve, sepse, siç thoshte ai, “jemi një komb i vogël; se vetëm bashkimi i plotë mund ta bajë të vlefshme atë forcë të paktë që kemi; se lakmuesit e tokës sonë dhe anmiqt e lirisë sonë nuk presin tjetër veç me përfitue, veç se grindjet midis nesh”.<sup>42</sup> Midis të tjerave, ai u kujtoi asamblistëve se kishin për detyrë të caktonin dhe formën e regjimit të qeverisjes për kohën e luftës, ku mbi të gjitha, të shprehej vullneti i patundur i kombit “të rrojë i bashkuar, i lirë dhe i nderuar”. Meqenëse nuk kishin ardhur të gjithë asamblistët e zgjedhur, mbledhja e dytë do të hapej më 18 tetor 1943.

Në përbërjen e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, të 18 tetorit 1943, bënë pjesë 187 vetë. Binte në sy se disa zona si: Dibër e Madhe, Pejë, Prizren, Prishtinë, kishin dërguar pjesën më të madhe të përfaqësuesve të

---

<sup>40</sup> Po aty, f. 29-42.

<sup>41</sup> Po aty, f.7-8.

<sup>42</sup> Po aty, f. 8. Fjala e Ibrahim Biçakut në mbledhjen e parë të Kuvendit Kombëtar, e shtunë, 16 tetor 1943, ora 16.

tyre në Kuvend. Mesa duket, përfaqësuesit nga këto treva ishin më të vendosur dhe më besnikë për t'iu përgjigjur situatës së re.

Për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve të Kuvendit Kombëtar, që ai të kishte një përfaqësim sa më të gjerë të zërit të shqiptarëve, u thirrën për të marrë pjesë dhe personalitete të njohura, përfaqësues të klerit si dhe bajraktarë të Malësisë, të cilët arrinin në 57 vetë.<sup>43</sup> Ftesa për këto persona u bë nga ana e Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm.

Në mbledhjen e dytë të Kuvendit Kombëtar të 18 tetorit 1943 u bë dhe betimi i asamblistëve, sipas një formule\*, të miratuar nga Kuvendi. Në procedimin e mëtejshëm Kuvendi zgjodhi kryesinë me kryetar Lef Nosi dhe sekretar Sokrat Dodbiba.

Vendimet më të rëndësishme, që kishin të bënin me pozitën politike të Shqipërisë në procesin e mëtejshëm të zhvillimit të Luftës Botërore, Kuvendi Kombëtar i mori në mbledhjen e tretë të tij, më 20 tetor 1943. Në këtë mbledhje u mor vendimi për rrëzimin e bashkimit personal të Shqipërisë me Italinë, sipas vendimit të Asamblesë së 12 prillit 1939, “mbasi ajo (Asambleja e 12 prillit 1939 – M.D.) nuk përfaqësonte vullnetin e lirë të popullit shqiptar”.<sup>44</sup> Rrëzohej, gjithashtu, Statuti i dekretuar më 3 qershor 1939 si dhe dekretligjet e nxjerra gjatë okupacionit italian. Mbi bazën e Kushtetutës së Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928, Kuvendi Kombëtar zgjodhi Këshillin e Lartë të Regjencës, i cili përfaqësonte shtetin dhe bashkë me Asamblenë kishte pushtetin legjislativ.<sup>45</sup>

Rivënia e dispozitave të Statutit të datës 1.12.1928, ishte mjaft e rëndësishme, sepse përfaqësonte një vendim juridik legjislativ që shënonte rikthimin e sovranitetit të shtetit shqiptar në situatën e Luftës Botërore. Me fjalë të tjera, ishte një vendim që rishpallte pavarësinë “e për me e bamë prap Shqipërinë të lirë, njashtu si ishte përpara ditës 7

<sup>43</sup> Po aty, f. 12-13.

\* “Beto hem në emën të Perëndisë e mbi nderin tem se kam për të ruejtun besnikisht mëvetsinë e tanësisë tokësore të Shqipërisë, se kam për t’i ndenj un besnik Atdheut e për t’u dalë zot Statutit e ligjeve të Shtetit e se kam për të kryer detyrën teme me ndërgegje të plotë për të mirën e përgjithshme, pa u pengue aspak prej interesash të veçanta a krahine”.

<sup>44</sup> Bisedimet e Kuvendit Kombëtar, Tiranë, 1944. Mbledhja e tretë, e mërkurë më 20 tetor 1943, f. 18.

<sup>45</sup> Po aty.

prillit 1939, kur forca e bajonetës e futi nën zgjedhën e fashizmit italian”<sup>46</sup>.

Në dokumentet e kohës ky Kuvend, me përfaqësues nga të gjitha krahinat shqiptare, u cilësua si “kuvend panshqiptar”. Duke pasur këtë atribut, Kuvendi abrogoi dhe e konsideroi të paqenë Dekretligjin e datës 3.6.1940, sipas të cilit, Shqipëria ishte në gjendje lufte me të gjitha ato shtete që Mbretëria e Italisë, ishte në luftë.<sup>47</sup> Me këtë vendim shpallej asnjëherë e Shqipërisë gjatë luftës. “Ne nuk kemi armiqësi me kërkënd, - shprehej Xhelal Mitrovica, - dhe në këtë përleshje gjigante, neve, si popull i vogël, nuk marrim pjesë as me njërin, as me tjetrin anë”. Dhe më tej, thuhej se, “Motoja e jonë ka qenë dhe asht qysh ditën e parë: bashkimi rreth Flamurit”.<sup>48</sup>

Nga ana tjetër, Neubacheri pranonte sovranitetin e Shqipërisë me një kufizim, se do të veprojë kundër çdo qeverie shqiptare, e cila do të përkrahte kundërshtarët gjermanë të luftës.<sup>49</sup>

Me fjalë të tjera, Shqipëria ose qeveria shqiptare nuk do të merrte pjesë në luftë me asnjërin nga palët e mëdha ndërluftuese, as me gjermanët, as me aleatët anglo-amerikanë, si një faktor i papërfillshëm për rezultatet e konfrontimit të tyre, por me shumë rëndësi për fatet e Shqipërisë. Shqipëria do të ruante pozicionin neutral deri në fund të luftës. Me këtë qëndrim Shqipëria kishte shanse të fitonte sovranitetin e plotë të saj, pas lufte.

Asnjëherë dhe neutraliteti i Shqipërisë në kuptimin formal, juridik, kishte vlerë edhe në raportet me Gjermaninë. Nuk kishte ndonjë ligj apo dekret të institucioneve legjislativë shqiptare, që ta detyronte shtetin shqiptar të ishte në gjendje lufte me ato shtete kundër të cilëve luftonte Gjermania.

Në fjalën e diskutantëve në Kuvendin Kombëtar u qartësua roli i ngritjes dhe i organizimit të organeve të qeverisjes së shqiptarëve në raport me rrethanat e brendshme e ndërkombëtare.

Roli i institucioneve shqiptare të kësaj periudhe, është konceptuar si pjesë plotësuese e përpjekjeve për shpëtimin e Shqipërisë, që ajo të mbetej si subjekt ndërkombëtar i pavarur, siç ishte para lufte.

<sup>46</sup> Po aty, f.17. Fjala e Lef Nosit në Kuvendin Kombëtar, 20 tetor 1943.

<sup>47</sup> Po aty, f. 19.

<sup>48</sup> Po aty, f. 23. Fjala e Xhelal Mitrovicës në Kuvendin Kombëtar.

<sup>49</sup> ADAP,E Bd.VII, dok.nr. 193; H. Neubacher, *vep. e përm.*, f. 113.

Një nga diskutantët, ndër të tjera, u shpreh se “ne duhet para çdo gjëje tjetër të mejtojmë shpëtimin e Shqipërisë.”<sup>50</sup> Në këtë kuadër, u tërhoq vëmendja për rrezikun që i kanosej vendit, nga anarkia. “Populli shqiptar është konservator, theksonte Mihal Zallari me oratorinë e tij, - dhe anarkinë e urren. Por, mjerisht, është tepër individualist”.<sup>51</sup> Jo rastësisht në rrahjen e mendimeve, për t’iu përgjigjur situatës, evidentohej se “një popull i vogël nuk bën politikë të madhe”. Me fjalë të tjera përcillej mesazhi se, shpëtimi i Atdheut do të vinte nga bashkimi i brendshëm i shqiptarëve. Ky mesazh iu drejtohej, në radhë të parë, “dallkaukëve që i bënin lajka popullit të vogël dhe djalërisë që, të molepsur nga ideologji antikombëtare shkallmonin substancën e kombit”.

Diskutimet në Kuvendin Kombëtar kishin një emërues të përbashkët politik. “Politika e jonë duhet të jetë zgjidhja e problemeve tona tue marrë parasysh rrethanat e sotshme e tue pas qëllimin e naltë për të mirën e Kombit e lirinë tonë dhe tue u kujdesue që të nxjerrim sa ma shumë dobina e psojmë sa ma pak dame”.<sup>52</sup>

Në diskutimet e Kuvendit Kombëtar u shtrua problemi jo vetëm i ruajtjes së Shqipërisë brenda kufijve ekzistues, por përfshirja brenda tyre edhe e viseve të tjera të paçliruara. “Shqipëria nuk asht plotësisht e lirueme. Kemi edhe shumë vise me rëndësi që kanë ngelur jashtë. Kemi Mitrovicën, Pazarin e Ri, Kumanovën, Preshevën, Kaçanikun e Shkupin, që nuk i janë bashkuar Shqipërisë”.<sup>53</sup> Pas kapitullimit të Italisë, delegatët e Kuvendit kërkuan që, “Sazani, si një ishull me shumë rëndësi, të merret në dorëzim nga shteti shqiptar, pra, të futej nën sovranitetin e këtij shteti”.<sup>54</sup> Gjithnjë, në funksion të krijimit të një shteti kombëtar shqiptar, u bënë dhe kërkesa të guximshme të tilla, siç ishte ndërtimi i një rruge automobilistike Theth-Shalë-Guci, për të jetësuar lirinë e krahinave shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Por arsyeja me rëndësi e kësaj lidhjeje ishte që ata të komunikonin me Shkodrën si qendër kulturore arsimore, kombëtare.<sup>55</sup>

<sup>50</sup> Bisedimet e Kuvendit Kombëtar, Tiranë, 1944, f.19. Nga diskutimi i Ali Koprenckës.

<sup>51</sup> Po aty, f. 47. Ligjërata e z. Mihal Zallari.

<sup>52</sup> Po aty, f. 50.

<sup>53</sup> Po aty, f.61. Mbledhja VI e Kuvendit Kombëtar, 23 tetor 1943.

<sup>54</sup> Po aty, f.57. Nga diskutimi i Idhomene Kosturit, 23 tetor 1943.

<sup>55</sup> Po aty, f.67. Nga fjala e përfqësuesit të Plavës e Gucisë në Kuvend.

Nga Kuvendi Kombëtar u zgjodh Këshilli i Lartë i Regjencës, i përbërë nga Mehdi Frashëri (kryetar), Lef Nosi, Anton Harapi dhe Fuad Dibra (anëtarë). Ky organizëm i lartë i shtetit shqiptar do të kryente funksionet e institucionit të Mbretit, gjatë periudhës së luftës. Kështu, Kuvendi shprehej, në një farë mënyre, hapur, për formën monarkike të shtetit shqiptar.

Formula e betimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Regjencës, në emër të Perëndisë dhe të nderit, ishte “për të qenë ruajtës besnik të mëvetësisë dhe tanësisë tokësore të Shqipërisë si dhe të statutit e ligjeve të Shtetit”.<sup>56</sup>

Mehdi Frashëri mbajti një ligjëratë para Kuvendit Kombëtar. Ai vuri në dukje se, mbledhja e Kuvendit Kombëtar shënonte një vazhdimësi të traditës institucionale të kombit shqiptar, i cili, sa herë është ndodhur para ngjarjeve me rëndësi, gjithmonë i është drejtuar institucionit të Kuvendit. Më tej, ai sqaroi se Kuvendi me një vetëdije të lartë mori vendime me rëndësi “të cilat suprimojnë njëherë e mirë gjithë pengimet ekonomiko-financiare që i kishte imponue Italia shtetit shqiptar”.<sup>57</sup> Me këto vendime që mori Kuvendi, duke anuluar konventat, ligjet dhe rregullat që kishin qëllim kolonizimin e Shqipërisë, “sot me gojë plot, - shprehej M. Frashëri, - mund të themi se populli shqiptar nga çdo pikëpamje politikisht, financiarisht dhe ekonomikisht, ndodhet krejt i lirë”.<sup>58</sup>

Ndërkaq, Mehdi Frashëri në ligjëratën e tij sqaronte bazën e pikëpamjes së tij dhe të kolegëve, lidhur me qëndrimin politik të mbajtur në ato rrethana të Luftës Botërore dhe raportet e Shqipërisë ndaj saj. Ata arsyetonin kështu: “Vetëm një gjë nuk duhet të harrojmë, se ndodhemi në një kohë lufte. Asnjë shtet në Ballkan nuk ka mbetur pa u okupue prej ushtrive ndërluftuese, mik ose armik. Ashtu edhe Shqipëria sot ndodhet nën okupacionin e ushtrisë gjermane, por kjo ushtri ka ardh si ushtri e një shteti mik\* dhe jo anmik e luftues kundra nesh”.\*\*

<sup>56</sup> Po aty, f. 87. Mbledhja IX e Kuvendit Kombëtar, 26 tetor 1943.

<sup>57</sup> Po aty, f.88. Ligjëratë e Mehdi Frashërit në mbledhjen e IX të Kuvendit Kombëtar, 26 tetor 1943.

<sup>58</sup> Po aty, f. 90.

\* Këtu ligjëruesi kujton vitet 1912 e 1913, kur Gjermania kishte marrë pjesë për krijimin e Shqipërisë si një shtet independent dhe i lirë.

\*\* Këtu ligjëruesi ka parasysh dallimin dhe veçoritë e okupacionit gjerman në krahasim me atë italian. Ky i fundit ishte një agresion i mirëfilltë e klasik. Ndërsa

Dhe më tej, arsyetimi vazhdonte: “Ndejtja e saj në tokat tona asht e lidhun me ngjarjet e luftës dhe mund të zgjatet disa javë ose disa muaj, por gjithmonë është e përkohshme dhe kjo gjë në asnjë mënyrë nuk i gjason aneksimit kolonial të përhershëm si ajo e Italisë”.<sup>59</sup>

Në opsionin që zgjodhën nacionalistët shqiptarë për të përshtatur një pozitë neutraliteti në atë situatë lufte, ndikoi edhe qëndrimi i politikës anglo-amerikane. Ishte mbështetja e pamjaftueshme e tyre “për t’u dhënë ngjarjeve në Ballkan një kthesë nga ky ose nga ai drejtim”. Në këto rrethana “Ishin popujt e këtyre vendeve, njerëzit e veçantë të vendosur ose grupet e organizuar me bindje ndërmjet tyre, që do të përcaktonin, nëse do t’u bëhej rezistencë efektive gjermanëve dhe se si do të dilnin vendet e tyre nga kjo luftë (natyrisht, kjo varej nga lëvizjet e ushtrive të Fuqive të Mëdha”....<sup>60</sup>

Mehdi Frashëri i bëri një kritikë të ashpër doktrinës komuniste e cila, sipas tij, ishte e huaj dhe nuk i përshtatej karakterit shqiptar. Ajo ideologji inspironte anarkinë, luftën civile midis shqiptarëve, duke minuar bashkimin e tyre.

Puna e parë që bëri Këshilli i Lartë i Regjencës ishte ajo e krijimit të qeverisë, me misionin, për t’i dhënë fund kaosit dhe për t’i siguruar qetësi dhe stabilitet të brendshëm Shqipërisë.

Qeveria e krijuar me 5 nëntor 1943, drejtohej nga kryeministri Rexhep Mitrovica, me përvojë të pasur e me reputacion politik. Në përbërjen e Qeverisë Mitrovica bënë pjesë: Rrok Kola - ministër i Drejtësisë, Mehmet Konica - ministër i Punëve të Jashtme, me zëvendës të tij Vehbi Frashërin, Sokrat Dodbiba - ministër i Financave, Ago Agaj - ministër i Ekonomisë, Musa Gjylbegu - ministër i Punës, Eqrem Çabej – ministër i Arsimit, por ai nuk e pranoi. Në vend të tij u emërua Koço Muka.<sup>61</sup> Fakti që ministrat e Qeverisë Mitrovica vinin nga grupime e shtresa shoqërore nga gjithë vendi, është një argument i pranueshëm, për të besuar se kjo qeveri synonte të kishte një karakter kombëtar,

---

gjermanët erdhën në Shqipëri si rezultat i raporteve të Fuqive të Mëdha ndërluftuese gjatë procesit të luftës, dhe nuk kishte të bënte me raportet e mëparshme shqiptaro-gjermane.

<sup>59</sup> Po aty, f. 89.

<sup>60</sup> R. Hibbert, *vep. e përm.*, f. 84.

<sup>61</sup> Bisedimet e Kuvendit Kombëtar (16 Tetuer – 10 Nanduer 1943), Tiranë, 1944, f. 93.

gjithëpërfshirës. Si e tillë ajo duhej të ngjallte shpresë e besim tek shqiptarët, për t'u bashkuar dhe për të kapërcyer sfidat që kishte përpara.

Kryeministri Rexhep Mitrovica shpalosi, para Kuvendit Kombëtar të gjitha sfidat e qeverisë të parashtruara në program. Në krye të programit të saj ishte “mbrojtja e pavarësisë së plotë dhe tanësisë tokësore shqiptare si dhe ngulmimi për të qenë zot i vendeve shqiptare mbi të cilat kërkojmë respektimin e të drejtave etnike dhe jetike të kombit tonë”. Duke pasur një qëllim të tillë, qeveria kombëtare (kështu u quajt ajo qeveri) përcaktoi dhe politikën e saj asnjëse me të gjitha shtetet ... Qeveria Mitrovica shpallte se kërkonte respektimin edhe nga shtetet e tjera të sovranitetit të kombit shqiptar “i cili brenda kufijve që i ka falun natyra, gjaku dhe historia kërkon të jetojë në harmoni dhe në qetësi të plotë brenda dhe jashtë”.<sup>62</sup> Suksesin dhe mbarëvajtjen e Qeverisë ai e kërkonte “në bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e të gjithë shqiptarëve pa dallim rryme e ideologjie”. Si detyrë të shenjtë dhe të padiskutueshme të qeverisë ai konsideronte “riorganizimin e ushtrisë dhe gjindarmërisë sonë”, e cila kishte mision mbrojtjen e kufijve etnikë.

Për organizimin e forcimin e gjindarmërisë, ai i referohej kohës së shtetit shqiptar të paraluftës, me besimin se gjindarmëria, “do t'i sigurojë popullit atë që i mungon: qetësinë shembullore, të dikurshme. Vendosjen e qetësisë së brendshme Mitrovica e konsideronte si një kusht të domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të kryhet asnjë veprim shtetëror”. “Programi qeveritar i Rexhep Mitrovicës ishte mjaft përparimtar”.<sup>63</sup>

Për zbatimin e këtij programi ndikuan faktorë të tjerë, duke e devijuar nga rezultatet e pritshme. Një nga këto faktorë ishte dhe mosveprimi i gjermanëve për deklaratat që kishin bërë lidhur me pozitën e Shqipërisë. Me sa duket ndikoi në këtë mes dhe mosnjohja ndërkombëtare e cila ishte pothuajse e pamundur në atë kohë Luftë Botërore.

Pavarësisht nga këto rrethana të luftës, pozita e Shqipërisë, pas ardhjes së gjermanëve, ndryshoi në mënyrë të ndjeshme në sensin e pavarësisë dhe të neutralitetit të shtetit shqiptar. Ndryshimi i pozitës së Shqipërisë, pas kapitullimit të Italisë, shpjegohej me veçoritë që kishte okupacioni gjerman, në raport me atë italian.

---

<sup>62</sup> Po aty, f. 94. Nga fjalimi i kryeministrit Rexhep Mitrovica në Kuvendin Kombëtar.

<sup>63</sup> B.J. Fischer, *vep. e për.*, f. 234.

1. Pas ardhjes së gjermanëve, si rezultat i zëvendësimit të pushtuesit italian, në Shqipëri u vendos një administratë civile dhe jo një administratë ushtarake, siç ndodhi në Greqi, Norvegji, Çekosllovakia, Jugosllavi etj. Kjo situatë e krijuar në Shqipëri, me krijimin e shtetit dhe të organizmave të tij, ishte diametralisht e ndryshme me administratën e mëparshme ushtarake italiane, që erdhi si rezultat i një agresioni e pushtimi ushtarak. Shqipëria trajtohej jo si “vend i pushtuar me dhunë”, por si një vend ku gjermanët do të bashkëpunonin me një qeveri shqiptare për të siguruar qetësi, rend dhe lëvizje të lirë. Në fund të fundit, këto ishin funksione të çdo shteti, në kuadrin e politikës së brendshme. Ky shtet kishte një administratë shqiptare, që zbatonte një legjislacion shqiptar dhe asnjë të tillë të përshtatur nga legjislacioni gjerman.

2. Nga Gjermania u deklarua dhe u pranua të mos bëhej aneksimi apo kolonizimi i Shqipërisë. Për rrjedhojë, nuk u bënë ndryshime të simboleve kombëtare, ndërrime të emrave të rrugëve apo emërtime të tjera, me qëllime të karakterit ideologjik. Një qëndrim i tillë, në pamje të parë simbolike ose “të rëndomtë”, siç shprehet ndonjë autor, flisnin shumë për moscenimin e ndjenjave kombëtare të shqiptarëve, në ndryshim me atë të sjelljes së pushtuesit të mëparshëm italian. Bashkëpunimi me shqiptarët nga ana e gjermanëve nuk bazohej mbi ideologjinë naziste, por mbi bazën e nevojave që kishte nxjerrë lufta, pra, ishte i përkohshëm.

3. Gjermanët respektuan dhe mbështetën statusin kombëtar të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera, që e bashkuan në një shtet të vetëm shqiptar. Nuk mund të konsiderohet thjesht si spekulim njohja e Shqipërisë Etnike dhe premtimi për t’u përfshirë në të dhe treva të tjera, por ishte një investim politik për çështjen kombëtare shqiptare, që pati ndikimin e vet në raportet shqiptaro-gjermane të kohës.

Shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera, që tashmë përfshiheshin në Shqipëri nën sovranitetin e shtetit shqiptar, nuk kërkonin asgjë më tepër se sa atë pozitë që kishin arritur, e cila ndryshonte katërcipërisht me gjendjen nën pushtimin sllav. Duke marrë në konsideratë dhe mbështetjen historike të gjermanëve në procesin e pavarësimit të shqiptarëve, nuk kishte ndonjë arsye për mosbesim ndaj premtimeve gjermane. Në këto rrethana historike, okupimi gjerman në Shqipëri pati një mbështetje të konsiderueshme, jo vetëm nga intelektualë e politikanë, të formuar në shkollat gjermane, por edhe nga një pjesë e madhe e shqiptarëve, që kishin shpresën për një zgjidhje vendimtare të çështjes

kombëtare shqiptare. Ndoshta, ky besim i shqiptarëve, për të realizuar aspiratat e tyre kombëtare, pas ardhjes së gjermanëve në Shqipëri, u arsyetua me këto veçori që përmendëm, të cilat kishin të bënin me sentimentet kombëtare të shqiptarëve, që ishin në kërkim të një mbështetjeje të jashtme të fuqishme.

Zhvillimi i Luftës Botërore, ku në lojë ishin Fuqitë e Mëdha ndërluftuese, do të ndikonin edhe në ecurinë e proceseve politike dhe ushtarake në Shqipëri.

### *S u m m a r y*

#### THE GERMANS IN ALBANIA

(summer – autumn 1943)

Based on the historical circumstances, created after the capitulation of Italy, this article presents different analyses on the political concernment of Albania. With its strategic importance regarding the plans and objectives of the Great Powers during World War II, Albania attired their attention. The attitude of the Great Powers towards the national interests of the Albanians, in some manner defined the latter's attitude regarding their relations with the fighting powers.

This study tries to treat the specificities of the German occupation in Albania, as compared to the Italian one. In accord with the German policy of not engaging multiple military forces in Albania, the Albanian government gained a larger territory in the country's administration, without the direct interference of the Germans.

After the arrival of the Germans in Albania, the Albanian politicians were lead by the conviction that they had to work in the interest of the Albanian Cause and, according to them, neutrality was the righter path towards the achievement of their goals by the end of the war.

The position of Albania after the arrival of the Germans changed clearly as long as the independence and the neutrality of the Albanian government were concerned. This position can be also explained by the specificities of the German occupation, as it was spread through the Albanian territory.

